

Në bazë të nenit 20 paragrafi 1 alinetë 1 dhe 15, e në lidhje me nenin 18 paragrafi 1 alineja 20 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (“Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16 dhe 132/17), neni 39 paragrafi 1 alinetë 1 dhe 15 dhe neni 15 paragrafi 1 alineja 19 nga Rregulorja e punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nr.01-4351/1 nga data 29.08.2014, duke marrë parasysh mos përputhjen e Ligjit për referendum dhe format e tjer të prononcimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve (“Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.81/05) me Kodin zgjedhor (“Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 32/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18 dhe 140/18), e në lidhje me nenin 12 dhe nenin 45 paragrafi 1 nga Ligji për referendum dhe format e tjer të prononcimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe nenin 192 nga Kodi zgjedhor dhe Konkluzioni i Këshillit të Agjencisë, nr.02-3725/2 nga data 17.08.2018, Këshilli i Agjencisë në mbledhjen e vet të 34-të të mbajtur më datë 17.08.2018, e miratoi:

UDHËZUESIN PËR PREZANTIM MEDIATIK GJATË REFERENDUMIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Me këtë doracak përcaktohen rregullat e propagandës publike për referendum dhe për heshtjen e referendumit, e që dalin nga Ligji për referendum dhe format e tjer të prononcimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve, Kodit zgjedhor, Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (LSHMAA) dhe Ligjit për medime.
2. Bazë për angazhimet programore dhe ato zyrtare të të gjithë radiodifuzerëve që do ta mbulojnë referendumin duhet të jenë parimet për prezantim të drejtë, të balancuar dhe të paanshëm mediatik të të gjitha palëve të interesuara në referendum si dhe të sigurojnë mundësi që qytetarët të kenë qëndrime sa më të llojlojshme juridike, politikologjike, politike dhe qëndrime tjera.
3. Palët e interesuara për referendumin janë propozuesi i atutorizuar, në këtë rast Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, si dhe subjektet tjera që bëjnë propagandë publike lidhur me referendumin.
4. Mbulimi i referendumin bazohet në: shkallë të lartë të pavarësisë redaktuese, pavarësi mediatike, etikë profesionale dhe integritet të gazetarëve.
5. Drejtuesi dhe/ose redaktori kryesor dhe përgjegjës i secilit prej radiodifuzerëve, duhet të njoftojnë me përmbajtjen e këtij udhëzuesi, të gjithë personat e përfshirë në përpilimin dhe realizimin e programeve në lidhje me referendumin.
6. Programet e radiodifuzerëve të dedikuara për referendumin, nuk guxojnë që të favorizojnë cilën do palë të interesuar për referendumin, ndërsa radiodifuzerët duhet të sigurojnë kushte të njëjta për qasje deri te programet e tyre.
7. Radiodifuzerët nuk guxojnë që të publikojnë informata dhe porosi me të cilat cënohet siguria nacionale, nxitet rrënim i dhunshëm i rendit kushtetues të RM-së, thirrret për agresion ushtarak ose konflikt të armatosur, nxitet dhe përhapet diskriminim, mosdurim ose urrejtje në çfarëdo baze, që është e ndaluar me ligj.
8. Redaktorët, gazetarët, udhëheqësit e programit dhe prezantuesit, që janë të angazhuar në përgaditjen e programeve të radiodifuzerëve nuk guxojnë të marrin pjesë në propagandën publike në lidhje me referendumin. Nëse përcaktohen për pjesmarrje në aktivitete të këtilla, angazhimi i tyre në programet e radiodifuzerëve duhet të pushojë deri në përfundimin e referendumin.

II. REFERENDUMI NËPËR LLOJE TË CAKTUARA TË PROGRAMEVE

Emisionet e informimit ditor (gazeta, ditorë)

9. Informimi për referendumin në emisionet e informimit ditor duhet të jetë i saktë (i vërtetë), në kohë dhe i kuptueshëm.
10. Informimi për aktivitetet në lidhje me propagandën publik që do ta bëjnë palët e interesuara për referendumin, radiodifuzerët duhet ta bëjnë në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshëm.
11. Informimi nuk duhet të jetë imponues dhe sugjerues. Dëgjuesve dhe shikuesve duhet t'u ofrohet përmbajtje informative e zgjeruar dhe e formësuar profesionalisht që do të ofrojë elementet për krijimin e mendimit dhe sjelljes personale.
12. Komentet që publikohen në emisionet e informimit ditor duhet të jenë të nënshkruar nga autori-gazetari ose nga redaksia, madje edhe kur janë marrë nga ndonjë komentues i pavarur ose nga ndonjë gazetar ose redaksi e medimeve të tjera.
13. Kur realizohen anketat nga gazetarët lidhur me mendimin e qytetarëve për referendumin, nevojitet që të sigurohet një qasje konkrete, kritere profesionale dhe të mbahet llogari që të prezantohen mendime të ndryshme në mesin e anketuesve.
14. Nuk duhet të publikohen rezultatet nga sondazhe tjera jo shkencore dhe jo reprezentative të mendimit publik, siç janë: votimet e shikuesve ose dëgjuesve përmes telefonit (televoting), anketat e realizuara përmes internetit, anketa të relizuara ndaj ndonjë shembulli joreprezentativ si dhe ato me pyetje sugjeruese.
15. Gjatë publikimit të rezultateve nga hulumtimet e mendimit publik në emisionet e informimit ditor radiodifuzerët duhet të respektojnë rregullat dhe afatet e përfshira në kreun III të këtij udhëzimi.

Programet e veçanta informative

(debatet dhe ballafaqimet, intervistat, programet aktuale-informative, programe aktuale-informative me qasje dokumentuese, programe informative me tematik të specializuar, programet e dedikuara për informimin e qytetarëve për mënyrën dhe teknikat e votimit në lidhje me referendumin)

16. Radiodifuzerët duhet të respektojnë rregullat për balancim, drejtësi dhe paanshmëri edhe në programet e veçanta informative dhe palëve të interesuara për referendumin t'u mundësohen kushte të barabarta për qasje të tyre.
17. Në emisionet debatuuese gazetarët duhet të sigurojnë fer-kushte në të cilat nuk do të cënohet dinjitetin e pjesëmarrësve në debat ose të vetë debatit.
18. Programet e veçanta të informimit nuk guxojnë që të shfrytëzohen si forma të propagandës së paguar publike.
19. Gjatë publikimit të rezultateve të hulumtimit të mendimit publik në programet e veçanta të informimit, radiodifuzerët duhet të respektojnë rregullat dhe afatet e përfshira në kreun III të këtij udhëzimi.

Llojet e tjera të programeve

(emisionet me funksion argëtues dhe arsimor, të përfshira me "Doracakun për klasifikimin e llojeve të programeve audio dhe audiovizuale", si dhe emisionet që kanë qëllim primar fëmijët dhe/ose të rinjtë)

20. Nëse bartësit e funksioneve publike ose përfaqësuesit e ndonjë pale të interesuar paraqiten në llojet e tjera të programeve, atëherë pjesmarrja e tyre nuk guxon që të jetë në funksion të propagandës publike në lidhje me referendumin.
21. Nëse persona të njohur publik, të kyçur në propagandën publike në lidhje me referendumin, marrin pjesë direkte ose si mysafir në produksionet e programeve tjera, atëherë ajo nuk guxon që të jetë në funksion të propagandës publike në lidhje me referendumin.

III. SHPALLJA E REZULTATEVE TË HULUMTIMIT TË MEDNIMIT PUBLIK

22. Gjatë shpalljes së rezultateve të hulumtimit të mendimit publik në lidhje me referendumin, radiodifuzeri është i obliguar që të theksojë këto të dhëna:
 - emri i porositësit të hulumtimit;
 - emri i institucionit që e ka zbatuar hulumtimit;
 - periudha kur është realizuar hulumtimi;
 - metodologjia e zbatuar;
 - madhësia e ekzemplarit të hulumtuar.
23. Rezultatet e hulumtimit të mednimit publik në lidhje me referendumin mund të shpallen më së voni pesë ditë para datës së caktuar për votim.

IV. OBLIGIMET E VEÇANTA TË SHËRBIMIT PUBLIK TË RADIODIFUZIONIT

24. Krahas parimeve dhe obligimeve të përgjithshme të këtij Doracaku që kanë të bëjnë me të gjithë radiodifuzerët, për Shërbimim publik të radiodifuzionit vlejné edhe këto obligime shtesë:
 - Në programet informative të dedikuara për informimin e votuesve të Shërbimit publik të radiodifuzionit duhet të sigurohet një edukim gjithpërfshirës, i detajuar dhe praktik i publikut për rregullativën ligjore në lidhje me referendumin, për përmbajtjen e pyetjes së referendumin dhe për mënyrën dhe teknikën e votimit;
 - Më së paku një emision informativ ditor, i emetuar në termin kryesor, duhet të bëhet edhe për personat me dëgjim të dëmtuar;
 - Një pjesë e programeve të veçanta informative, kushtuar referendumin duhet të bëhen edhe për personat me dëgjim të dëmtuar;
 - Nuk guxon të emetohet propagandë e paguar politike.

V. E DREJTA E PËRGJIGJES OSE KORRIGJIMIT

25. Secila palë e interesuar për referendumin, ka të drejtë që të kërkojë nga radiodifuzeri që të publikojë korrigjimin ose përgjigjen e informatës së publikuar në të cilën theksohen të dhëna të pasakta, me të cilat janë shkeluar të drejtat dhe interesat e tyre, në pajtim me procedurën e përcaktuar me Ligjin për medime.

VI. PROPAGANDË E PAGUAR PUBLIKE

26. Radiodifuzerët duhet të krijojnë kushte për qasje të barabartë të palëve të interesuara në referendum deri te format e propagandës së paguar publike (spoteve reklamuese, informatave, shpalljeve, spoteve muzikore që funksionojnë si hymën i palëve të interesuara për referendumin, incizimet e mitingjeve, takimeve dhe ngjarjeve tjera të palëve të interesuara për referendumin që emetohen me kompensim financiar).
27. Për propagandën e paguar publike, radiot dhe televizionet mund të ndajnë gjithsejtë 9 minuta në cdo orë reale, të emetuara si kohë shtesë. Ndërsa 12 minutat për reklamim sipas Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, nuk guxojnë që të shfrytëzohen për emetim të propagandës së paguar publike për referendumin.
28. Nga gjithsejtë 9 minutat e propagandës së paguar publike, duhet të ndahen dy pjesë të barabarta (nga 4 minuta e 30 sekonda), njëra për subjektet që do të agjitojnë për përgjigjen “PRO” të pyetjes së referendunit, kurse tjetra për subjektet që do të agjitojnë për përgjigjen “KUNDËR” pyetjes së referendunit ose që do të agjitojnë për bojkot të referendunit. Në këtë drejtim, secili subjekt i interesuar mund të blejë më së shumti gjysmën e kohës së përgjithshme, të ndarë për propagandë të paguar publike, respektivisht 4 minuta e 30 sekonda.
29. Çmimet e shërbimeve të propagandës së paguar publike duhet të jenë të njëjta për palët e interesuara për referendum dhe nuk duhet të ndryshohet nga dita e miratimit të listës së çmimeve deri në përfundim të referendunit.
30. Propaganda e paguar publike duhet të ndahet qartë nga programet e radiodifuzerëve dhe nga porositë e tjera reklamuese dhe të shënohet dukshëm si propagandë e paguar publike, kurse porositësi duhet të shënohet qartë gjatë tërë kohëzgjatjes së propagandës së paguar publike.
31. Për përmbajtjen e formave të emetuara të propagandës së paguar publike përgjigjen porositësit e tyre.
32. Në propagandën e paguar publike nuk guxojnë të marrin pjesë të mitur.
33. Radiodifuzerët duhet të refuzojnë emetimin e propagandës së paguar publike nëse me të çënohet siguria nacionale, nxitet rrënimi i dhunshëm i rendit kushtetues së RM-së, thirret për agresion ushtata ose konflikt të armatosur, nxitet dhe përhapet diskriminim, mosdurim ose urrejtje në çfarëdo baze të ndaluar me ligj, ose nëse në propagandën e paguar publike bëhet keqpërdorim i fëmijëve për qëllime politike.

34. Propaganda e paguar publike nuk mund të emetohet në: emisionet e informimit ditor, në programet e veçanta informative, si dhe gjatë transmetimeve të drejtpërdrejta të ngjarjeve fetare, sportive, kulturore, argëtuese dhe ngjarje tjera.
35. Propaganda e paguar publike nuk mund të emetohet gjatë, para ose pas emisioneve që kanë qëllim primar fëmijët dhe/të rinjtë.

VII. HESHTJA E REFERENDUMIT

36. Heshtja e referendumit fillon 48 orë para ditës së votimit dhe përfundon me mbylljen e vendotimeve, në ora 19:00.
37. Radiodifuzerët edhe gjatë heshtjes vazhdojnë që të informojnë për ngjarjet e jetë shoqërore, përfshirë edhe referendumin si ngjarje më e rëndësishme politike.
38. Të gjitha format e propagandës në lidhje me referendumin duhet të përfundojnë patjetër më së voni 48 orë para ditës së votimit.
39. Gjatë informimit në ditët e heshtjes për referendumin do të konsiderohet si shkelje e heshtjes nga mediumi nëse emetojnë, respektivisht publikojnë çfarëdo informata, fotografi, materiale audio dhe audiovizuale në lidhje ose ku marrin pjesë përfaqësues të palëve të interesuara; çfarëdo forma të informimit mediatik që janë haptazi ose fshehtazi në funksion të propagandës publike të ndonjërës palë dhe mund të ndikojnë në vendimin e votuesve; të dhëna me të cilat zbulohet identiteti i përfaqësuesve të palëve të interesuara të përfshira në incidente dhe parregullsi tjera gjatë ditës së votimit si dhe deklarata nga përfaqësues të palëve të interesuara në referendum si dhe nga bartësit e funksioneve të pushtetit.
40. Gjatë heshtjes së referendumit, për të shmangur çfarëdo ndikimi ndaj pavarësisë së vendimit të qytetarëve, radiodifuzeri është i obliguar që të kushtojë vëmendje si vijon:
 - ajmet, raportet, deklarata, kumtesat, intervistat si dhe komentet dhe nënlojet e këtij zhanri, si forma të përpunimit informativ dhe analitik të temave, ngjarjeve dhe ndodhjeve në lidhje me referendumin – nuk guxojnë që të theksojnë burimet e informatave as nga ana e propozuesve të autorizuar e as nga cila do palë e interesuar në referendum;
 - në ditën e votimit, kumtesat zyrtare ose deklaratat e incizuara të propozuesve të autorizuar ose nga ndonjë palë e interesuar për referendumin, radiodifuzeri mund t'i emetojë vetëm pas mbylljes së vendotimeve, respektivisht pas orës 19.00;
 - për të mos u shfrytëzuar redaksitë ose gazetarët – me ose pa qëllim për kryerje të propagandës publike në lidhje me referendumin, duhe t'i kushtohet vëmendje e veçantë keqpërdorimeve të mundshme të burimeve të informimit, para se gjithash në aspekt të - informimit për incidente të konstruara, respektivisht - informimi për referendumin duhet të dalë nga burime zyrtare të informimit, të përcaktuara me "Ligjin për referendum dhe forma tjera të pronocnimit të drejtpërdrejt të qytetarëve" si – "Organe për zbatimin e referendumit" (Komisioni shtetëror zgjedhor; Komisionet komunale zgjedhore; dhe Këshillet zgjedhore).
41. Si burime zyrtare të informimit konsiderohen edhe mbikëqyrësit e akredituar vendas dhe të huaj, që nuk janë të lidhur me palët e interesuara në referendum.
42. Në rast të informimit për forma të pengimit të votimit (fizike, verbale, incidente dhe shkelje të ngjashme), krahas të lartpërmendurve, si burim zyrtar konsiderohet edhe Ministria e Punëve të Brendshme. Informimi për rastet e këtilla në ditën e votimit, duhet t'i përmbahen etikës së supozimit të pafajësisë,

respektivisht në raportet e gazetarëve të publikuara deri në orën 19.00, nuk d'het të zbulohet identiteti i kryerësi potencial i veprës penale.

VIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

43. Mosveprimi dhe moszbatimi i udhëzimeve të përcaktuara në këtë udhëzues nga ana e radiodifuzerëve mund të paraqesë bazë për ndërmarrje të masave adekuate, të përcaktuara me ligj në këto raste.
44. Ky Udhëzim hyn në fuqi me ditën e miratimit, ndërsa do të publikohet në ueb faqen e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Nr. 01-3764/1

17.08.2018,
Shkup

**Agjencia për shërbime mediatike
Audio dhe audiovizuale**

Kryetar i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI